LIGJ
Nr. 98/2012

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHTETIT PËR VITIN 2011

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 63 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit për vitin 2011, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

	Në milionë lekë
1. Buxheti i Shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	275 479
Shpenzimet, gjithsej	309 297
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
Të ardhurat	86 267
Shpenzimet	85 317
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
Të ardhurat	13 965
Shpenzimet	26 974
4. Deficiti buxhetor	- 45 877
5. Financimi i deficitit buxhetor	45 877
I brendshëm	26 119
A. Me instrumente financiare (kredimarrje e brendshme, neto)	28 175
1. Kredimarrje nga pushteti qendror	28 106
Bono thesari	9 947
Obligacione qeveritare 2/3/5-vjeçare	18 159
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	69
B. Të ardhura nga privatizimi	438
C. Të tjera	- 2 494
Ndryshimi i gjendjes së arkës	- 2 283
Të tjera	- 211
Financimi i jashtëm (neto)	19 758
Nga i cili:	
Mbështetje buxhetore	2543

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.10.2012

Shpallur me dekretin nr.7802, datë 30.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani